

U D H Ë Z I M
Nr. 36, datë 21.5.2001

PËR CAKTIMIN E NUMRIT DHE VENDNDODHJES SË QENDRAVE TË VOTIMIT

Në mbështetje të nenit 35 pika 2, 41, 47, 91 dhe 92 të ligjit nr.8609 datë 8.5.2000 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

U D H Ë Z O N:

Për ngritjen e qendrave të votimit, caktimin e numrit dhe vendndodhjen e tyre, KZZ- të në bashkëpunim me KZQV-të dhe kryetarin e bashkisë apo komunës përkatëse, do të procedojnë si vijon:

1. Në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të 24 qershorit 2001 do të përdoret i njëjti numër i qendrave të votimit që u përdor në zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të 1 tetorit 2000.

2. Shtesa të qendrave të votimit do të bëhen vetëm për qendrat studentore (konvikte) të universiteteve, një qendër votimi për jo më pak se 800 dhe jo më shumë se 1000 votues.

3. Nisur nga fakti që një zonë zgjedhore për deputetët përfshin më shumë se një bashki apo komunë, renditja do të relizohet sipas renditjes së bashkive, komunave ose lagjeve në tabelën e ligjit nr.8746 datë 28.2.2001 “Për caktimin e zonave zgjedhore”, e cila veças për çdo zonë zgjedhore iu dërgohet së bashku me modelin 29 të vendimit të KZZ-së “Për caktimin e vendndodhjes së qendrave të votimit”, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

4. Në spitale, burgje, vende paraburgimi ngritja e KQV-ve dhe qendrave të votimit bëhet si rregull në të njëjtin numër që u ngritën për zgjedhjet e 1 tetorit 2000. Nëse pas tetorit 2000 është ndërtuar ndonjë institucion i ri i kësaj natyre, atëherë duhet parashikuar edhe një qendër votimi shtesë.

5. Për caktimin e vendndodhjes së qendrave të votimit do të procedohet si vijon:

-Qendrat e votimit, si rregull, caktohen në objekte publike, si shkolla, konvikte, kopshte, çerdhe, ambulanca, qendra shëndetësore apo kulturore etj. të kësaj kategorie.

-Kur në territorin e zonës së qendrës së votimit nuk ka objekte si ato të përmendura më lart, KZZ-ja vendos t'i propozojë KQZ-së krijimin e qendrës së votimit në një objekt privat (orientuar si rregull nga i njëjti numër i përdorur në zgjedhjet e 1 tetorit 2000) dhe, me marrjen e konfirmimit zyrtar nga KQZ-ja, shpallet vendndodhja dhe ngrihet qendra e votimit.

Në plotësimin e kësaj detyre, KZZ-të duhet të mbajnë parasysh që vendndodhja e qendrës së votimit, si rregull, të jetë e njëjtë me atë të përdorur në zgjedhjet e 1 tetorit 2000.

Mbi bazën e procedurave të përcaktuara në këtë udhëzim, KZZ-ja merr vendim sipas modelit 29 të dokumenteve të miratuar nga KQZ-ja, si dhe shpall vendndodhjen e qendrës së votimit sipas modelit 29/1.

5. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilirian Celibashi